



DHOMA E AVOKATISË TIRANË
Av. Arbër HOXHA
Licence: 4252
NIPT L 01721002 R

Rr. Haxhi Hysen Dalliu, Pallati Nordin, Zyra Nr. 8, Tiranë

Cel: +355694290448

Tiranë, më 21.12.2020

KËRKESË

KËRKUES:

Altin Avdyli, i biri i Zeqos, i dtl 27.02.1977, lindur dhe banues në Shijak, Durrës, aktualisht me masë sigurimi "Arrest në burg", IEVP 313, Jordan Misja, **Tiranë**, mbrojtur nga **Av. Arbër Hoxha**, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me Liçencë me Nr.4252 dhe NIPT L01721002R me adresë: Rr. Haxhi Hysen Dalliu, Pallati Nordin, Zyra Nr. 8, Tiranë

PALË E INTERESUAR:

Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

OBJEKTI:

Përfashtimin e Gjyqtares, znj. Daniela SHIRKA nga gjykimi i cështjes me nr. 38, me te pandehur, Gjevi Ndoka, Altin Avdyli, etj akuzuar, për kryerjen e veprave penale të „Prodhimi dhe shitja e narkotikëve“ kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar përkatësisht nga Neni 283/1 dhe 334 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE:

Nenet 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 17/1/b, 17/1/ë, 18, 19 dhe 21 e vijues te K.Pr.Penale.

PER KOMPETENCE:

Gjykata e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

I nderuar Z. Kryetar!

Gjykata e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me trupen gjyqsore me relatores znj. Gjyqtare Miliana Muca, dhe anëtare znj. Etleva Deda dhe znj. Daniela Shirka është duke gjykuar çështjen me nr. 38, me te pandehur, Gjevi Ndoka, Altin Avdyli, etj; akuzuar, për kryerjen e veprave penale të „Prodhimi dhe shitja e narkotikëve“ kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar përkatësisht nga Neni 283/1 dhe 334 i Kodit Penal.

Parashtrimi i rrethanave të faktit dhe shkaqet e përjashtimit.

Ab initio

Pranë Prokurorisë e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është regjistruar Procedimi Penal Nr. 339/2016.

Ish Gjykata e Shkallës së Parë për Krime Tiranë, ka lëshuar Vendimin Nr. 157, datë 21.10.2018, masën e sigurimit në mungesë, për Hajri Seferi, Altin Avdyli, Astrit Avdyli, Elis, Guri, etj.

Më pas procedimi penal Nr. 339, u nda në 4 fraksione.

Gjykata e Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me relatores znj. Danile Shirka, me Vendimin Nr.28, date 28.10.2020, (per të njëjtin procedim) ka vendosur:

1. Ramadan Dushaj me 9 vite burgim, uljen e 1/3 të dënimit dhe përfundimisht me 6 vite burgim.

2. Rezart Cacani me 9 vite burgim, uljen e 1/3 të dënimit dhe përfundimisht me 6 vite burgim.
3. Neritan Saraçi me 7 vite burgim, uljen e 1/3 të dënimit dhe përfundimisht me 4,8 vite burgim.
4. Ardit Haxhagiqi me 8 vite burgim, uljen e 1/3 të dënimit dhe përfundimisht me 5,4 vite burgim.
5. Vilson Noka me 14 vite burgim, uljen e 1/3 të dënimit dhe përfundimisht me 9,4 vite burgim.
6. Fatbardh Gostini me 7,6 vite burgim, uljen e 1/3 të dënimit dhe përfundimisht me 5 vite burgim.
7. Luan Boça me 7 vite burgim, uljen e 1/3 të dënimit dhe përfundimisht me 4,8 vite burgim.

Duke qënë se për të njëjtin procedim është shprehur më vendim, kjo gjyqtare Daniela Shirka, nuk mund të gjykojë ceshtjen me penale nr. 38, me të pandehur, Gjevi Ndoka, Altin Avdyli, etj.

Ligji i zbatueshëm

Kërkesa jonë gjën mbështetje në:

Neni 42/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".

Që këtej rrjedhin parimet e një procesi të rregullt ligjor:

- a) E drejta e një gjykimi të drejtë dhe publik;
- b) Brenda një afati të arsyeshëm;
- c) Nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme
- d) Nga një gjykatë e caktuar me ligj

Neni 18 i K. Pr. Penale sanksion: "1. Palët mund të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit:

- a) në rastet e parashikuara nga nenet 15, 16 dhe 17;

b) kur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe para se të jetë dhënë vendimi ai ka shfaqur mendimin e tij mbi faktet ose rrethanat objekt procedimi.

Neni 17/1/ë i K. Pr. Penale sanksionon se: "Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete:
ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie

Neni 19 i K. Pr. Penale sanksionon se: "1. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit bëhet në seancë menjëherë pas legjitimitit të palëve.
2. Kur shkak i përjashtimit lind ose zbulohet pas mbarimit të momentit të legjitimitit të palëve, kërkesa duhet të bëhet brenda tri ditëve nga konstatimi. Kur shkak ka lindur ose është zbuluar gjatë séances kërkesa e përjashtimit duhet të bëhet para mbarimit të seancës.
3. Kërkesa përmban shkaqet e provat dhe parashtrohet me akt të shkruar. Ajo paraqitet, bashkë me dokumentet, në sekretarinë e gjykatës kompetente. Një kopje e kërkesës i jepet gjyqtarit për të cilin kërkohet përjashtimi.
4. Kur nuk bëhet personalisht nga palët, kërkesa mund të paraqitet me anën e mbrojtësit ose të një përfaqësuesi të posaçëm. Në prokurë duhet të tregohen shkaqet për të cilat kërkohet përjashtimi, ndryshe ajo nuk pranohet"

Neni 21 i K. Pr. Penale sanksionon se: "1. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në dhomë këshillimi nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë.
1/1. Gjyqtari për të cilin është kërkuar përjashtimi paraqet me shkrim mendimin e tij mbi kërkesën për përjashtim.
2. Për kërkesën e përjashtimit të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë vendos një kolegji i kësaj gjykate, i ndryshëm nga ai të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.
3. Nuk pranohet kërkesa për përjashtimin dhe as ripërsëritja e kërkesës për të njëjtat shkaqe e gjyqtarëve të caktuar për të vendosur mbi përjashtimin.

KËRKOJMË :

Perfundimisht, për sa më sipër, ne baze të Neneve 42/2 të Kushtetutës, Nenit 18, 17/1/ë, 19 dhe 21 e vijues të K.Pr.Penale kerkojme nga Gjykata Gjykata e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar:

Përjashtimin e Gjyqtares, znj. Daniela SHIRKA nga gjykimi i çështjes me nr. 38, me te pandehur, Gjevi Ndoka, Altin Avdyli, etj, akuzuar, për kryerjen e veprave penale të „Prodhimi dhe shitja e narkotikëve“ kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar përkatësisht nga Neni 283/1 dhe 334 i Kodit Penal

KËRKUESI
Altin Avdyli

Mbrojtësi
Av. Arbër HOXHA

P.S: Bashkëlidhur kërkesës gjene:

1. Vendimin Nr. 157, datë 21.10.2018 të ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime Tiranë.
2. Vendimin Nr.28, date 28.10.2020 të Gjykates se Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.